

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimi në Hagë ngre shqetësime për sigurinë në Kosovë, ekspertët apelojnë për qetësi dhe shmangie të provokimeve
ADRESA	https://albeu.com/kosove/vendimi-ne-hage-ngre-shqetesime-per-sigurine-ne-kosove-eksperte-t-apelojne-per-qetesi-dhe-shmangie-te-provokimeve/1012352/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA

KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 10:11:48 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 10:10:34 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8d2e79634f0cb7bed6f05d63c7e370f404a0f7949302abd3d143f99c173a9dc9
TEKSTI	ca1e667b7605267119981252a4e0e43042ff90c094ea48befd372805573009a8
PAMJA	4326f8517fd4264d0982584b4a324e412578b4429b6b8c4e6a5a56c39e8e7f2e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	35bb877396041ad3135f479dcd69297026fe726feb7a2bca3a152c3f53de84a2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0ae22dd21f6bca70f134e59ae1dafa22b8b5d83b679efc36f84697e742e9fc20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/35bb877396041ad3135f479dcd69297026fe726feb7a2bca3a152c3f53de84a2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Vendimi në Hagë ngre shqetësime për sigurinë në Kosovë, ekspertët apelojnë për qetësi dhe shmangie të provokimeve



Më 16 shtator, Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë pritet të shpallin aktgjykimin ndaj ish-presidentit Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarëve Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli, si edhe ish-deputetit Rexhep Selimi. Ata përballen me akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, ndërsa të katërt janë deklaruar të pafajshëm për të dhjetë pikat e aktakuzës.

Për të njëjtën datë janë paralajmëruar protesta, ndaj Ambasada Amerikane në Prishtinë u ka kërkuar shtetasve të Shteteve të Bashkuara që të mos lëvizin pranë zonave ku pritet të zhvillohen tubimet.

Njoftimi i ambasadës ka shtuar shqetësimet në opinionin publik se, varësisht nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës Speciale, mund të ketë protesta të dhunshme dhe trazira në Kosovë dhe në rajon.

Profesori i shkencave të sigurisë, Avni Islami, në një deklaratë për "Bota sot", u bëri thirrje qytetarëve të Republikës së Kosovës që të tregojnë qetësi, maturi dhe vigjilencë.



të fundit /



Real Madridi përgatitet të ofrojë 87 milionë euro për Adam...



Më të mirët e xhiros së gjashtë në Superligën e Kosovës



Arrestohet në Belgjikë Jasin Avdyli, i dënua me 12 vite burg në...



Nipi i Jakup Krasniqi: Kosova pret vendimin përfundimtar, historia ...



Përpam Rama për ndarjen nga jeta të Flora Brovinës: Ajo d...



Bedri Hamza për ndarjen nga jeta të Flora Brovinës:...



Tirana shlyen gjobën 5 milionëshe, tifozët rikthehen ndaj...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Sipas Islamit, Serbia është duke përdorur lajme të rreme për të krijuar përshtypjen se në Kosovë do të ketë trazira, si pjesë e një lufte hibride. Ai vlerëson se këto përpjekje nuk do të kenë sukses përballë pjekurisë së qytetarëve.

Islami deklaroi se, vetëm pak orë përpara shpalljes së verdiktit për krerët e UÇK-së, propaganda dhe shërbimet inteligjente serbe, përfshirë BIA-n dhe struktura të tjera, janë aktivizuar në një nivel të paparë më herët.

Ai tha se në media dhe në rrjetet sociale po qarkullojnë deklarata të bujshme dhe informacione të pavërteta për trazira të sajura në Kosovë. Sipas tij, ky skenar, së bashku me stërvitjet e fundit të ushtrisë serbe pranë kufirit të Kosovës, përbën një luftë të mirëfilltë hibride, e cila do të dështojë falë pjekurisë së popullit.

Duke paralajmëruar kundër provokimeve dhe dezinformatave, profesori kërkoi nga qytetarët që të ruajnë qetësinë dhe të veprojnë me maturi.

Ai theksoi se qytetarët nuk duhet t'u besojnë informacioneve të rreme që synojnë të shkaktojnë panik, ndërsa bashkëpunimin dhe besimin e tyre ndaj institucioneve e cilësoi si mbrojtjen më të fuqishme.

Sipas Islamit, Agjencia Kosovare e Inteligjencës, AKI, dhe Policia e Kosovës ndodhen në gatishmëri të plotë dhe janë të forta e të pathyeshme. Ai shtoi se çdo përpjekje e agjenturave të huaja ose e elementeve destabilizuese për të nxitur provokime dhe për të cenuar rendin kushtetues do të neutralizohet menjëherë, duke nënvizuar se siguria e Republikës së Kosovës është e garantuar dhe e pacenueshme.



Edhe eksperti i sigurisë Valdet Hoxha foli për pritshmëritë rreth vendimit, duke vlerësuar se aktgjykimi i Gjykatës Speciale ndaj katërshes së UÇK-së po ndiqet me interes të madh si në Kosovë, ashtu edhe në arenën ndërkombëtare.

Hoxha shpjegoi për "Bota sot" se kjo çështje mund të shërbejë si precedent për raste të një natyre të ngjashme në të ardhmen.

Sipas tij, përvoja e drejtpërdrejtë e qytetarëve të Kosovës në luftën çlirimtare mund t'i shtyjë ata të shfaqin emocionet dhe pritshmëritë që kanë ndaj këtij procesi. Kjo, siç tha ai, mund të krijojë në opinion perceptimin se një aktgjykim eventual jo-lirues mund të pasohet nga tensione dhe trazira në vend.

Eksperti e konsideroi planin operativ të Policisë së Kosovës për 16 shtatorin si një veprim standard procedural dhe operacional. Ai theksoi se kjo masë është e nevojshme për sigurinë, por nuk paragjykon rezultatin dhe nuk lidhet në asnjë mënyrë me vendimarrjen e pavarur të Gjykatës Speciale.

Në përfundim, Hoxha u shpreh optimist për aktgjykimin, duke thënë se pret që trupi gjyqës të marrë një vendim të pavarur dhe të pandikuar, pa u dhënë besim pretendimeve të ngritura nga prokuroria.

Ai argumentoi se lufta e UÇK-së ishte e drejtë dhe çlirimtare, e imponuar nga pushtimi i egër dhe dhuna e Serbisë. Hoxha shtoi se ajo ishte mbi të gjitha një luftë vullnetare, e përkrahur nga partnerët ndërkombëtarë të udhëhequr nga SHBA-ja, të cilët morën pjesë në mënyrë aktive në çlirimin, pavarësinë dhe shtetndërtimin e Kosovës.

Shtuar më 15.09.2026 12:10

Tags: [alarm](#), [Polici i Kosoves](#), [siguria](#)



Nipi i Jakup Krasniqit:
Kosova pret vendimin
përfundimtar, historia e s...



Përparim Rama për ndarjen
nga jeta të Flora Brovinës:
Ajo do të jetë pjesë e...



Bedri Hamza për ndarjen
nga jeta të Flora Brovinës:
Trashëgimi e qëndresës...



Bekteshi: Gjashtë vota
mund të vendosin mes
presidentit dhe zgjedhjev...



Keith Self paralajmëron
Hagën: Vendimi për Thaçin
të mos ndikohet nga...



Tërmkolli kundërshton
retorikën kërcënuese para
vendimit të Hagës: Thaçi...



Ndahet nga jeta Flora
Brovina në moshën 76-
vjeçare



Islami apelon për qetësi:
Mos u ndikoni nga
provokimet dhe lajmet e...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

[Kontaktimi](#) | [Kushtet e Përdorimit](#) | [Privacy Policy](#) | [Powered by: orihost.com](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.